

VENDIM
Nr. 69, datë 11.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 18, DATË 4.2.2022, “MBI DEPOZITIMIN NGA OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES (OSSH SHA), PËR MIRATIM NË ERE TË KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË DHE KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E TIJ”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 104, pika 1, nenit 155, pikat 1 dhe 2, dhe nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/8 prot., datë 7.4.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 18, datë 4.2.2022, mbi zgjatjen e afatit për depozitimin nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrta të pajtueshmërisë dhe kriterëve për përzgjedhjen e tij”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendim nr. 18, datë 4.2.2022, ka vendosur që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune dhe pas miratimit nga organet drejtuese të shoqërisë, të përcjellë për miratim në ERE kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrta të pajtueshmërisë dhe kriteret minimale, kriteret profesionale, si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse për zyrarin e pajtueshmërisë, të cilat do t'i bashkëlidhen kontratës, si pjesë integrale e saj.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 289 prot., datë 21.2.2022, dhe nëpërmjet shkresës nr. 463 prot., datë 5.4.2022, i rikujtoi detyrimin për të plotësuar sa kërkuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 18, datë 4.2.2022.

- Brenda afatit 30-ditor të marrjes së vendimit nr. 18, datë 4.2.2022, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 289/1 prot., datë 5.4.2022, shoqëria ka kërkuar mirëkuptimin e ERE-s për shtyrjen e afatit të hartimit të kësaj kontrate deri në fund të muajit qershor, në kuadër të përballimit të situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike të përdoruesve të OSSH sh.a., në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga zbatimi i VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, për të garantuar aksesin e shpërndarjes së energjisë elektrike në mënyrë të pandërprerë.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë OSSH sh.a. për zgjatje të afatit është depozituar në zbatim të legjislacionit në fuqi brenda afatit dhe është e arsyetuar, vlerësohet që të pranohet dhe të zgjatet afati për depozitimin nga OSSH sh.a. për miratim në ERE të kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrta të pajtueshmërisë dhe kriterëve për përzgjedhjen e tij deri më 30.6.2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 18, datë 4.2.2022, ndryshon dhe bëhet:

“2. Propozimet e OSSH sh.a., sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, të dërgohen në ERE brenda datës 30.6.2022.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti